



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr. 1025 prot
111

Datë, 15 / 05 / 2019

VENDIM
Nr. 5 datë 9 / 5 / 2019

PËR
SHTYRJEN E VENDIMIT PËR MIRATIMIN E LEJES
MIRATIMIN E LEJES "PËR HAPJEN E PESË PUSE-SHPIMI", FSHATI MULLET,
NJËSIA ADMINISTRATIVE PETRELË, BASHKIA TIRANË, PËR SUBJEKTIN
"ALAR CONSULTING" SH.P.K

Në zbatim të ligjit Nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të ndryshuar, përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2, vendimit nr. 416 datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", vendimit nr.221 datë 26.04.2018 "Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore" paragrafi III, pika 5 gërma "i", vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", neni 16 gërma "c", Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

KONSTATOI SE;

- Nga shqyrtimi i kërkesës së subjektit "ALAR CONSULTING" për hapjen e pesë puse-shpimi" me vendodhje fshati Mullet, njësia njësia administrative Petrelë, bazuar në diskutimet e anëtarëve të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm Erzen për dhënien e lejes "për hapjen e një pus-shpimi" të shtyhet vendimmarrja për afatin e vlefshmërisë së licencës së hartuesit të Raportit të VNM-së, pasi është jashtë afateve. Nga diskutimet e anëtarëve u kërkuar gjithashtu që të sqarohet a ndikon hapja e këtyre pesë puse shpimi në pusët e Ujësjellës Kanalizime Tiranë.

Për këto arsye Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

V E N D O S I :

1. Shtyrjen e Vendimit për "Miratimin e lejes për hapjen e pesë puseve shpimi, me qëllim përdorimi për ujitje, për subjektin "ALAR Consulting", fshati Mullet, Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë, me këto të dhëna:

Pusi AD7

- Koordinatat në KRGJSH të pusit të projektuar: X=489692, Y=4571067, Z=218 m
- Kapaciteti i parashikuar 0.5 l/s
- Thellësia e pusit 250 m
- Diametri i shpimit të pusit 0-12 m=Ø408 mm, 12-250m=Ø356 mm
- Qëllimi i përdorimit: Ujë për ujitje

Pusi AD8

- Koordinatat në KRGJSH të pusit të projektuar: X=489867, Y=4571096, Z=224 m
- Kapaciteti i parashikuar 0.5 l/s
- Thellësia e pusit 256 m
- Diametri i shpimit të pusit 0-12 m=Ø408 mm, 12-250m=Ø356 mm
- Qëllimi i përdorimit: Ujë për ujitje

Pusi AD9

- Koordinatat në KRGJSH të pusit të projektuar: X=489912, Y=4571025, Z=233 m
- Kapaciteti i parashikuar 0.5 l/s
- Thellësia e pusit 256 m
- Diametri i shpimit të pusit 0-12 m=Ø408 mm, 12-250m=Ø356 mm
- Qëllimi i përdorimit: Ujë për ujitje

Pusi AD10

- Koordinatat në KRGJSH të pusit të projektuar: X=489836, Y=4570964, Z=224 m
- Kapaciteti i parashikuar 0.5 l/s
- Thellësia e pusit 256 m
- Diametri i shpimit të pusit 0-12 m=Ø408 mm, 12-250m=Ø356 mm
- Qëllimi i përdorimit: Ujë për ujitje

Pusi AD 11

- Koordinatat në KRGJSH të pusit të projektuar: X=489817, Y=4571025, Z=230 m
- Kapaciteti i parashikuar 0.5 l/s
- Thellësia e pusit 256 m
- Diametri i shpimit të pusit 0-12 m=Ø408 mm, 12-250m=Ø356 mm
- Qëllimi i përdorimit: Ujë për ujitje

2.Ky vendim shtyhet për arsyet e mëposhtme:

- Të shtyhet afati i vlefshmërisë së licencës së hartuesit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, pasi rezulton që në momentin e shqyrtimit të dokumentacionit në mbledhjen e KBU Ishëm-Erzen i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së licencës.

- Të sqarohet që hapja e këtyre puseve nuk ka ndikim në puset e Ujësjellës Kanalizime Tiranë për furnizimin me ujë të popullatës.

3. Ngarkohet ZABU Ishëm-Erzen-Mat për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi

4. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR

Adrian SHTINO



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

